



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2776 Prot.
15

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 22.09.2025

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 në orën 14:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltare:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Liljana Mesutaj
4. Erald Çepele
5. Lori Musaj
6. Artan Velçani
7. Klarida Semanjaku
8. Armand Ahmetaj
9. Smerald Hazizaj
10. Elmira Rama
11. Renaldo Shpata
12. Vjollca Kasaj
13. Novrus Toska
14. Eduart Faslliaj
15. Gani Ahmetaj
16. Shezai Sinanaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë!

Të nderuar qytetarë!

Kjo është mbledhja e këshillit bashkiak e cila është thirrur në bazë të nenit 53 pika 4 dhe 56 pika 2 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 16 këshilltarë.

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

1- Miratimi i rendit të ditës.

2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.08.2025.

3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.08.2025.

- 4- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin gusht 2025".
- 5- Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin gusht 2025".
- 6- Projekt-vendim "Për miratimin e zbatimit të projektit "Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët "Heronjtë e Linasit", Shpiragu dhe Degëzim i rrugës "Sulo Goxhaj".
- 7- Projekt-vendim "Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve "Arsimi Bazë" në programin "Furnizimi me ujë" për objektin "Shtim rrjeti KUZ në bllokun Vresht, Lagjja e Re".
- 8- Projekt-vendim "Për miratimin e projekt dokumentit të rishikuar faza e dytë, të Programit buxhetor afatmesëm 2026-2028.
- 9- Projekt-vendim "Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 27.11.2024, "Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025".
- 10- Projekt-vendim "Për shfuqizimin e vendimit nr. 53 datë 18.08.2025, "Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2025-2030".
- 11- Projekt-vendim "Për miratimin e transferimit të nxënësve të shkollës "Sotir Çapo" Zharrës".
- 12- Për miratimin e raportit "Për një zëvendësim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 "Për rishqyrtimin, miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme i ndryshuar.
- 13- Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Patos në Këshillin e Qarkut Fier.
- 14- Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë.

Paraprakisht para se të kalojmë në votimin e rendit të ditës dua t'ju informoj se rendi i ditës është hartuar në bazë të gjitha rregullave që janë përcaktuar në ligj dhe rregullore, gjithashtu janë mbledhur dhe komisionet pra të citoj vetëm pikën 10 i cili është komisioni i ligjeve dhe pikat e tjera i ka shqyrtuar komisioni ekonomisë.

Nëse keni ndonjë propozim për ndryshime të rendit ditës për shtim ose për heqjen e ndonjë pike?

Eduart Faslliaj - Po kryetar kisha unë një propozim lidhur me pikën 13 për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit Bashkiak të Bashkisë pranë Qarkut meqënëse ne në mbledhjen kryesisë nuk kemi dakortuar ashtu sikundër ram dakord ditën e konstituimit të këshillit që një nga përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut do ti takonte opozitës meqënëse ne nuk e kemi dakortuar këtë, nuk e kemi diskutuar pavarësisht se si pikë e futëm në rendin e ditës nuk u diskutua mendoj që ta shtyjme për mbledhjen tjetër këtë pikë të dakortojmë, të diskutojmë dhe pastaj ta kalojmë si projektvendim në mbledhjen e radhës.

Armand Ahmetaj- faleminderit Doshi nuk mundet ta bëjmë të sepse e kemi kaluar të gjitha afatet për zëvendësimin qoftë në komisione, Këshillin e Qarkut pra ka disa afate ligjore që nuk na lejojnë të zgjasim më dhe nuk kemi dhe pse ta zgjasim, nuk kemi arsye, ne jemi të gjithë këshilltarët këtu dhe ju jeni të lirë të propozoni kë të doni, ne respektojmë afatet ligjore.

Eduart Faslliaj- dakord kur është afati ligjor meqë po thoni?

Armand Ahmetaj- i kemi tejkaluar

Eduart Faslliaj- Kur është pra

Armand Ahmetaj- i kemi tejkaluar që nga vdekja e të ndjerës dy muaj ka afat.

Eduart Faslliaj- Nga momenti i emërimit të këshilltarit të ri ka ndonjë afat kohor?

Armand Ahmetaj- Duhet të ishte zëvendësuar pra.

Eduart Faslliaj- Nuk më thua dot, s'ka problem, unë mendoj sipas procedurës që kemi ndjekur jemi dakordësuar politikisht për personat dhe pastaj i kemi kaluar në rend dite, megjithatë ju e keni fuqinë e kartonave, mund të keni kthyer dhe mendim, por unë mendoj që duhet të procedojmë siç kemi rënë dakord se ka qënë me votë unanime nga i gjithë këshilli, është dakorduar qoftë dhe anëtari i këshillit të qarkut, përfaqësuesi i opozitës është votuar dhe nga ju.

Armand Ahmetaj- Do të jetë prapë përfaqësues nga opozita dhe nuk na lejon ligji as ta çojmë më falni të jetë mashkull duhet të jetë femër për shkak të ligjit për barazinë gjinore.

Eduart Faslliaj- e kuptoj kryetar po ideja ishte ne si grup, a do ketë përfaqësues opozita unë mendoj që jam anëtar i grupit të opozitës ne më së paku nuk kemi krijuar një grup me vacancën që na u krijua të duhet proceduralisht të krijojmë një grup të sjellim një dokument shkruar kur të kemi përcaktuar edhe kryetarin e grupit pastaj do duhet të dakordojmë këto për sa kohë se kemi bërë këtë unë nuk e shoh të arsyeshme që të vazhdojmë procedurat hapa te radhës.

Armand Ahmetaj- unë mendoj se ligji na e lejon që të vazhdojmë dhe nuk na krijon asnjë pengesë dhe këtu do dalim prapë te ky vendim që do të marrim sot.

Eduart Faslliaj- kryetar ne nuk ju kemi sjell akoma një vendim grupi si do e trajtoni ju përfaqësues të opozitës?

Armand Ahmetaj- tani kryesia e këshillit dhe unë si kryetar i këshillit mbaj përgjegjësi për këtë pjesë ne duhet ta kishim zëvendësuar pra dhe duhet të ishte zëvendësuar edhe në komisione edhe në qark kemi tejkaluar afatet.

Eduart Faslliaj- e kuptoj për sa kohë ne nuk kemi sjellë shkresën ju do të përcaktoni vet ngelet për të parë.

Armand Ahmetaj - nuk na krijon pengesa ti mund ta bësh propozimin që sot s'ka problem ne jemi të hapur këtu.

Eduart Faslliaj- Po nëse personi që propozoni nuk pranon?

Armand Ahmetaj - Procedura e lejon që të japi dhe dorëheqjen, po tani procedurat ndodhin që edhe anulohen nuk është hera e parë apo e fundit që kemi procedura që na anulohen.

Eduart Faslliaj – ne nuk kemi ndonjë afat.

Armand Ahmetaj- Unë do ta hedh propozimin tënd në votë

Eduart Faslliaj- Afatet janë të përcaktuara në ligj nuk hidhen në votë

Arman Ahmetaj- Jo propozimin po them që ta shtyjme se i kemi tejkaluar të gjitha afatet.

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendit e ditës?

Miratohet me 14 vota pro 1 abstenim, 1 kundër .


SEKRETARE

Refaela Xeba



KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2746 Prot.
16

Patos më 26.09.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 18.08.2025.

Armand Ahmetaj – Kemi ndonje pyetje, propozim, korrigjim?

Nese skemi gjë tjetër miratohet pika 2 në bazë të nenit 77 pelqimi unanim.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smirerol Hoxhaj

Lori Musaj

Pendulo Shkrota

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2446 / 1 Prot.

Patos më, 26 09.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 18.08.2025

Armand Ahmetaj – Fjala për Refaelën

Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 18.08.2025 u morën gjithsej 11 vendime nga nr. 44 deri në 54.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 47, 48, 49, 53, 54 i janë përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe na ka ardhur përgjigja se 3 vendime janë në përputhje me ligjin.

Vendimi nr. 53 datë 18.08.2025, “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030”, është kthyer nga Prefekti si në kundërshtim me ligjin.

Vendimi nr. 54 datë 18.08.2025, "Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027", dhe shfuqëzimin e VKB nr. 30 datë 30.06.2025" Për miratimin e Planit të Integritetit për periudhën 2025-2027", kthehet sepse verifikimi i ligjshmërisë së tij nuk është në kompetencën e Prefektit. Gjithashu më lejoni t'ju bëj me dije se në datë 11.09.2025 patëm një kontroll në vend nga Prefektura ku objekti i kontrollit ishte verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative të organit përfaqësues dhe organit ekzekutiv të bashkisë Patos, për periudhën qershor-gusht 2025 si dhe Vendimet e kthyera nga Prefekti si vendime në kundërshtim me ligjin për periudhën objekt verifikimi.

Si përfundim për periudhën qershor - gusht 2025 nuk ka akte normative të padepozituara për verifikim ligjor nga Prefekti i Qarkut Fie.r

1 Akt është kthyer si në kundërshtim me ligjin, 1 akt kthehet sepse verifikimi i ligjshmërisë së tij nuk është në kompetencën e Prefektit.

Për periudhën qershor - gusht 2025 nuk ka akte të kundërshtuara për pavlefshmëri në gjykatë.

Faleminderit!

SEKRETARE

Refaela Xeba

Simona Horica
Lori Musaj
Rendro Shyda

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2774 Prot.

13

Patos më 26 09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin gusht 2025".

Mitjon Nikolla – Drejtor i Drejtorisë të Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social

Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social paraqet përpara jush projektvendim nr. 57 datë 15.09.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin gusht 2025".

Propozojmë përfitimin e ndihmës ekonomike nga fondet e buxhetit vendor për muajin Gusht 2025 gjithsej 15 familje me një fond prej 59,385 (pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

Do kërkoja mirëkuptimin tuaj pasi kemi pasur një lapsus në projektvendim, një gabim domethënë në shkrimin e vlerës e kemi shënuar 56,385 ndërkohë nga tabela nga lista emërore e muajit gusht 2025 vlera e saktë është 59,385 (pesëdhjetë e nëntë mijë e treqind e tetëdhjetë e pesë) lekë. Pra kërkoj saktimin e vlerës në projektvendim.

Lori Musaj- komisioni ekonomisë dhe financave u mbledh ditën e premte datë 19 dhe shqyrtoj projektvendimin e mësipërm i cili është argumentuar në përputhje me bazë ligjore dhe vendosi të miratojë pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin gusht 2025" bashkë me ndryshimet që sapo citoi Mitjoni.

Kush është dakord?.

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

Smevold Hoxhi

Lori Musaj

Renaldo Shyqete

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 27481 Prot.
13

Patos më 26 09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin gusht 2025".

Mitjon Nikolla – Drejtor i Drejtorisë të Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social -Projektvendim nr. 58 datë 15.09.2025 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6% për muajin gusht 2025".

Drejtoria e Mbrojtjes Sociale dhe Politikave të Arsimit, Sektori i Shërbimit Social propozon të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara 6% për muajin Gusht 2025, 18 familje me një fond prej 66,543 (gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind e dyzetë e tre) lekë.

Familjet përfituese sipas listës dhe relacionit të cilin mund ta lexojë në qoftë se do dëshironi. Lori Musaj- në mbledhjen e komisionit ekonomisë është diskutuar dhe ky projekt vendim i cili gjithashtu paraqitet në përputhje me bazën ligjore dhe e kemi miratuar pas një ndryshim duke votuar me tre vota pro faleminderit

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje spo propozim?

Armand Ahmetaj –Nëse s'kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin gusht2025".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?
Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerdet Hoxhi
Lori Musaj
Rendita Shpota

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 27721 Prot.
13

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim "Për miratimin e zbatimit të projektit "Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët "Heronjtë e Linasit", Shpiragu dhe Degëzim i rrugës "Sulo Goxhaj".

Ermenita Mici - përshëndetje të gjithëve përsa i takon këtij projektvendimi ne e kemi bërë një rishikim dhe një vlerësim të ecurisë së investimeve të realizuara deri në këtë fazë përsa i takon buxhetit të vitit 2025, nga ky vlerësim kemi parë të gjithë investime të cilat ishin parashikuar ato që janë përfunduar në të cilat kemi çlirim fondi dhe ato investime të cilat deri në këtë fazë nuk janë kryer tashmë.

Nga ky vlerësim kemi bërë hartimin e projektit për përmirësimin e shtresave rrugore në 3 rrugë të qytetit të cilën e kemi vlerësuar si prioritet dhe domosdoshmëri.

Praktikisht këto rrugë janë heroit e Linasit rruga Shpiragu dhe degëzimi rrugës Sulo Goxhaj.

Atëherë rruga Heronjtë e Linasit besoj është të qartë se për cilin segment rruge bëhet fjalë rruga Shpiragu i referohet rrugës tek lagja e Re pas Raiffeisen bankë dhe degëzimi rrugës Sulo Goxhaj është rruga që është parashikuar në projektin tek sheshi në të cilën aktualisht po punohet për realizimin e fasadës nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Vlera për hartimin e këtij projekti është 17,249,728.97 lekë me tvsh dhe kjo vlerë do të mbulohet nga fondet e dy viteve 25 dhe 26 e cilat janë përcaktuar dhe në relacion nga se do të përfitohen.

Në këto kushte i kërkojmë këshillit të bashkisë të miratojë këtë projektvendim.

Lori Musaj – mbledhja e komisionit është zhvilluar ditën e premte, kemi diskutuar me ekzekutivin në lidhje mbi këtë projektvendim i cili është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojnë pa asnjë ndryshim duke votuar tre vota pro.

Eduart Faslliaj- Meqënëse unë kam munguar ditën mbledhjes së komisionit ekonomisë meqë kemi këtu dhe kryetarin e bashkisë meqë këto janë fondet të çliruara kryetar dhe sikurse na janë thënë dhe në relacion janë përmirësim të shtresave të këtyre rrugëve që janë specifikuar do të doja të sjell në vëmendjen tuaj që një pjesë të vogël të këtij fondi ne mund ta kishim kaluar në segmentin e vogël të rrugës lagjes Mustafa Matohiti që është bërë gangrenë prej kaq vitesh, pse sna e keni marrë në konsideratë vajti kaq kohë çfarë po ndodh me atë segment rrugor?

Kryetari i Bashkisë- Problemi i Lagjes Mustafa Matohiti është për shkak të problemit që ka qenë, problemit ligjor më saktë por gjithsesi ne do të shohim hapësirën ligjore, nuk është e nevojshme që të përfshihet këtu për tu bërë pasi është një sasi asfalto beton që nuk është e konsiderueshme dhe ne kemi mundësi për ta bërë si ndërhyrje por problemi ka qenë vetëm pjesa ligjore për ndërhyrje në atë pjesë por do ta rivlerësojmë dhe të shohim mundësinë që të ndërhyjmë për ta bërë si mirëmbajtje rrugës se investim nuk mund të quhet.

Do ta vlerësojmë, nuk kanë nevojë të përfshihet këtu pasi kemi bazë materiale për të bërë ndërhyrje nuk është problem kjo pjesë. Ngelet për tu vlerësuar, nuk mund të them një përgjigje të saktë.

Eduart Faslliaj – Përveç atij segmenti janë dhe tre-katër gropa që janë në gjysmën e segmentit të rrugës

Kryetari i Bashkisë- Për pjesën e ndërhrjes në riparime të ndryshme mund të ndërhyjmë pasi bëj një ndërhyrje para disa para disa ditësh kemi bërë një pjesë të mirë të të qytetit për riparimin e gropave dhe atje Agjencia e Shërbimeve Publike mund ta ketë lënë për një moment të dytë por do t'ia vendos në vëmendje që të ndërhyhet më shpejt për pjesën e riparimit duke qenë se tani do shtrohet dhe rruga që është në Rërës rruga Xhelaj gjatë shtrimit të asaj rruge po bëjmë edhe riparimin për këto gropa që janë në lagjen Mustafa Matohiti.

Armand Ahmetaj – Propozoj të kalojmë në votim e pikës gjashtë Projekt-vendim “Për miratimin e zbatimit të projektit “Përmirësim i paketës së shtresave asfaltike në rrugët “Heronjtë e Linasit”, Shpiragu dhe Degëzim i rrugës “Sulo Goxhaj”.

Kush është dakord?

Miratohet me 16 vota pro, ska kundër, abstenim ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerdet Hoxhaj

Lori Musaj

Perdho Shyrtaj

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 279 Prot.
13

Patos më 26 09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve “Arsimi Bazë” në programin “Furnizimi me ujë” për objektin “Shtim rrjeti KUZ në bllokun Vresht, Lagjja e Re”.

Ermenita Mici- përsa i takon këtij projektvendimi siç e dimë aktualisht por zhvillohen punimet për rikonstruksionin e rrugës të rrugëve të bllokut të vreshtit për arsye se mungesës së informacionit nga ana drejtorisë së projekteve po ashtu dhe nga shoqëria ujësjellës kanalizimeve të cilat nuk disponojnë një hartë të qartë dhe të saktë të rrjetit të kanalizimeve për qytetin e Patosit ka ndodhur që si pasojë e kësaj mungese të informacionit të mos përfshihen të gjitha pikat e mundshme për realizimin e rrjetit të kanalizimeve në këtë lagje.

Gjatë fazës së hapjes së gjurmës së rrugëve janë vërejtur këto problematika gjithashtu referuar dhe ankesave të vetë qytetarëve të cilët janë paraqitur pranë bashkisë Patos dhe kanë referuar problematikën e tyre për mungesën e kanalizimeve është parashikuar që ne të ndërhyjmë vetë me anë të Agjencisë së Shërbimeve Publike.

Për realizimin e pjesës së munguar të rrjetit të kanalizimeve në këto segmente është parashikuar gjithë baza materiale e nevojshme që do do të blihet nga transferimi i fondit të cilët kërkojmë miratimin e këshillit nga arsimi bazë në programin e furnizimit me ujë ky fond është çliruar nga rikonstruksioni i kopshtit me drekë Patos dhe kërkojmë që ta transferojmë për realizimin e këtyre kanalizimeve në bllokun e Vreshtit.

Lori Musaj- në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili gjithashtu është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojmë pa asnjë ndryshim duke votuar me tre vota pro.

Eduart Faslliaj- Meqenëse jemi këtu si banori lagjes Mustafa Matohiti dhe si anëtar i këshillit bashkiak të asaj zone desha të përgëzoja ekzekutivin për gjithë ndërhyrjet që është bërë në KUZ në Margëlliç në lagjen Mustafa Matohiti qoftë për sasinë dhe qoftë për cilësinë e punimeve sigurisht solidarizohem me vendimin e komisionit ekonomisë dhe jam në mbështetje të transferimit të këtij fondi për këtë qëllim.

Armand Ahmetaj – Kalojmë në votim e pikës shtatë Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të fondit midis programeve “Arsimi Bazë” në programin “Furnizimi me ujë” për objektin “Shtim rrjeti KUZ në bllokun Vresht, Lagjja e Re”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 16 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Smerdet Hoxhi

Lori Musaj

Rencho Shyti

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 277/1 Prot.

Patos më 26.09.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e projekt dokumentit të rishikuar faza e dytë, të Programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Mimoza Shtëmbari- Drejtore Financës- Atëhere në zbatim të ligjit 68 Për vetëqeverisjen e pushtetit vendor dhe udhëzimi standard për përgatitjen e buxhetit afatmesëm ky projektvendim është përgatitur duke zbatuar fazat një pas një të këtyre ligjeve dhe udhëzimeve që përmendëm.

Në këtë buxhet të rishikuar i cili shoqërohet me tabelat dhe relacionin nga PBA1 deri në PBA 9 Ka ndryshim vetëm PBA 8 që ka të bëjë vetëm me listën e investimeve të përditësuar me pikën shtatë të vendimit të sapo votuar nga ju për pjesën e përmirësimit asfaltik të tre rrugëve.

Të tjerat janë të pandryshuara jemi në kushtet që burimet nuk kanë ndryshuar edhe tavanët nuk ka asnjë ndryshim në këtë fazë burimet janë po ato, ky është buxheti i fazës së dytë të rishikuar reflektimet për shtesat me ndryshimet e paketës fiskale dhe të burimeve do të vijnë me buxhetin përfundimtar në nëntor.

Bashkëngjitur keni relacionin keni tabelat.

Lori Musaj- Në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar dhe mbi këtë projektvendim i cili gjithashtu është argumentuar në përputhje me bazën ligjore dhe kemi vendosur ta miratojnë pas një ndryshim duke votuar me tre vota pro.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord me pikën tetë projektvendim “Për miratimin e projekt dokumentit të rishikuar faza e dytë, të Programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”.

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE

Refaela Xeba

Smerol Hoxhi

Lori Musaj

Rendita Shyete

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2704 / 13 Prot.

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së nëntë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.

Mimoza Shtëmbari- Ky projektvendim vjen për miratimin e nivelit të pagave që kanë të bëjnë vetëm në Qendrën Multifunkionale të krijuar nga bashkia në bazë të projekteve të fituara nga fondi social me Ministrinë e Shëndetësisë.

Për tu qartësuar ne kemi një fituar një projekt në 2023 për krijimin e kësaj qendre Multifunkionale i cili është 3 vjeçar me bashkëfinancim nga Ministria e Shëndetësisë dhe nga bashkia.

Në fazën kur u shkruajt dhe u paraqit për konkurim ky projekt ishim referuar dhe Ministria edhe ne në nivelin e pagave të atëhershme dhe pagat për këtë kategori që shërbejnë në këtë qendër janë parë të asaj kohe tani duke qenë se targetgrupi dhe frekueca është rritur në atë qendër dhe ngarkesa e punës dhe gjithashtu kemi dhe një mungesë për lokoped propozojmë të rritet niveli pagave të këtyre punonjësve të kësaj qendre nga niveli ekzistues për menaxherin e projektit 40-62 dhe për punonjens sociale dhe psikologe nga 34 e 500 në 600.

Efekti finnciar do të mbulohet nga fondi i kontigjencës i cili është miratuar me buxhetin e vitit 2025.

Erald Çepele- Nga cila datë shtrihet efekti financiar?

Mimoza Shtëmbari- Nga 1 shtatori.

Albiona Lamaj- Duke marr shkas dhe për shkak të mënyrës sesi funksionon ajo qendër multifunkionale dhe shërbimet që jep pyetja ime do të ishte kjo është maksimale e pagave që mund të japim ne për ato punonjëset atje është maksimalja e lejueshme kemi mundësinë që të marrin më shumë se kaq sepse realisht puna që ato bëjnë duhet të shpërblehet më shumë se kjo pagë tani nëse është mundësia dhe kemi mundësi të mund ta bëjmë këtë gjë?

Mimoza Shtëmbari- Në projekt këto janë specialistë të këtij projekti dhe niveli specialistëve dhe diplomat përkatëse maksimale janë 60 deri në 65.

Eduart Faslliaj -se ju thatë 3 arsye për të cilat është bërë ndryshimi i pagës një ishte ndryshimi nivelit pagave të atëherë kur miratua projekti me këtë të tanishme, arsyeja dy thatë ngarkesa e fluksit punës dhe treta ishte shpërndarja mesa kuptova unë një page të logopedit e cila mungonte.

Mimoza Shtëmbari- jo kjo e treta.

Kryetari i Bashkisë- Fatkeqësisht numri dhe kërkesa te ajo qëndër janë në rritje vazhdimisht për fat të keq dhe jemi të detyruar me ngarkesën që kanë që paga të rritet mbase edhe të shtohet edhe numri punonjësve shpresojmë që mos e nevojshme por duke parë ecurinë besoj se do jetë e nevojshme edhe shtimi i punonjësve të tjerë tek ajo qendër.


Për momentin ne kemi financimi i pagës së tyre bëhet bashkë me Ministrisë Shëndetësisë duke mosrenduar buxhetin e bashkisë por duke kaluar vitet me 3 vite fillon 90-60 edhe 30 që është vitin e 3 që është vitin e ardhshëm ne do të riaplikojmë përsëri besoj në qoftë se do ketë thirrje gjatë vitit të ardhshëm të Ministria, do aplikojmë me të njëjtën program që pesha e bashkisë të jetë më e ulët.

Elmira Rama- nisur edhe nga përvoja ime e punës në një qendër sociale të tillë mendoj se është propozuar një vendim që duhet ta miratojmë, punonjësit do të motivohen dhe jam e sigurt e them e bindje që përfitimi do të jetë direkt tek fëmijët që trajtohen nga kjo qendër. Faleminderit!

Armand Ahmetaj –Kush është dakord me pikën nëntë - Projektvendim “Për një ndryshim të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 83 datë 27.11.2024, “Mbi miratimin e nivelit të pagave të bashkisë institucioneve në vartësi, njësive administrative dhe funksioneve të transferuara për vitin 2025”.


Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba



KRYETAR
Armand Ahmetaj

Lori Musaj
Rendelha Shyete





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2745 Prot.
13

Patos më 26.09.2024.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 53 datë 18.08.2025, “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2025-2030”.

Çajup Refitaj- Në mbledhjen e datës 18.08.2025 Këshilli i Bashkisë Patos miratoi “Planin Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2025-2030” me vendimin nr. 53, datë 18.08.2025.

Pas miratimit nga Këshilli i Bashkisë vendimi iu dërgua për konfirmim ligjshmërie Prefektit të Qarkut.

Me shkresën nr. 953., datë 10.09.2025, Prefekti i Qarkut Fier e ka kthyer vendimin në kundësthim me procedurën e kërkuar nga ligji nr. 91, datë 28.02.2013 me arsyetimin se nga ana jonë duhej të merrj Deklarata e Ministrit të Mjedisit për Vlerësimin Strategjik, për këtë arsye kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

Shfuqizimin e vendimit nr. 53, datë 18.08.2025 “Për Miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2025-2030” deri në pajisjen me Deklaratën e Ministrit të Mjedisit ku plani do të miratohet sërish për të bërë ndryshimet në përmbajtje.

Klaudio Alisinanaj- Komisioni i ligjeve pasi u mbledh ditën e premte dhe pasi dëgjoi argumentimin ekzekutivit arriti ta miratoj me 3 vota pro shfuqizimin e vendimit nr. 53 datë 18.08.2025.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord me pikën dhjetë - Projektvendim “Për shfuqizimin e vendimit nr. 53 datë 18.08.2025, “Për miratimin e Planit Lokal të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve të Ngurta Urbane 2025-2030”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerod Hoxhaj
Lori Musaj
Rendro Shydo

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 27891 Prot.
17

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së njëmbëdhjetë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për miratimin e transferimit të nxënësve të shkollës “Sotir Çapo” Zharrës”.

Mitjon Nikolla - Fatmirësisht në shkollën e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz, Patos do të fillojë rikonstruksioni total i objektit, pasi jemi në fazën e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes së objektit dhe si pasojë lind nevoja e transferimit të nxënësve të kësaj shkolle me qëllim zhvillimin e procesit mësimor në kushte normale. Në këtë shkollë zhvillojnë procesin mësimor 204 (dyqind e katër) nxënës.

Nga këta për 108 kërkohet transporti përkatësisht të nxënësve të klasave në klasë gjashtë deri në klasën e dymbëdhjete kërkohet transportit drejt shkollës Koli Dimo Frashër për arsimin fillor nga klase parë deri në të pestë me numër total prej 58 nxënësish, kërkohet zhvillimi i procesit mësimor në një ambient të themi të marrë me qera në Zharrës pasi ne nuk e mundësojmë një ambient të tillë publik që të ta kishin falas.

Ndërsa për një pjesë tjetër të nxënësve diferenca domethënë e këtij numri nuk është nevoja pasi janë në fshatrat Verbas dhe Frashër dhe nuk kanë nevojë as për transport e kanë afër.

Kryetari i Bashkisë- Dukë qënë se është shkollë e bashkuar nga klasa e parë deri në klasën e pestë janë banorë të zonës ku është shkolla. Lind nevoja për transport vetëm për ata që janë të gjimnazit.

Mitjon Nikolla- përse më sipër ju kërkua drejtorisë së shërbimeve përllogaritje të një çmimi të transportit kostove të transportit ose të themi biletës vajtje ardhje nga shkolla Sotir Çapo në shkollën Koli Dimo në Frashër dhe për një total prej 130 ditë mësimore pasi në vijim duke parë ecurinë e kontratës dhe realizimin e punimeve të objektit do të shikohet faza përfundimtare nëse do të nevojitet vijim i transportit apo jo.

130 ditë mësimore është llogaritur vlerën për 108 nxënës me një vlerë biletë 80 lekë vajtje ardhje është llogaritur vlera 1 milion e 123 mijë e 200 lekë në relacion keni edhe një tabelë me përllogaritjen e vlerës gjithashtu bashkëlidhur keni dhe për procesverbalin nga drejtoria e Shërbimeve

Shërbimi i transportit do të jetë në përputhje me legjislacionin e transportit nxënësve në Republikën e Shqipërisë ndërsa përse i përket kërkesës tjetër nga drejtoria e shkollës për sigurimin e një ambienti për zhvillimin mësimor në Zharrës për nxënësit e arsimin fillor nisur edhe nga mosha e tyre kërkesa qëndron pasi e kanë më të vështirë domethënë transportin sikurse nxënësit e klasave më të larta për këtë qëllim është studiuar tregu zonës përreth shkollës është menduar një godinë e

përshtatshme e ndarë në ambiente përkatëse për pesë klasat si dhe për pjesën e stafit pedagogjike e cila të ketë minimalisht tre tualete të jetë rreth 200 m² me çmim për 200 lekë metri katror i qerasë mujore dhe kjo shkon rreth 40 mijë lekë në muaj parashikimi jonë keni llogaritur tetë muaj këtu pasi muaj i parë pothuajse po ezaurohet kështu që kemi llogaritur një vlerë prej 320 mijë lekë për pjesën e qerasë për arsimin fillor për 58 nxënës. Shpenzimet do të mbulohen brenda programit të “Arsimit bazë” nga çlirimi i fondit të objektit “Rikonstruksioni kopshtit me drekë, Patos”. Për arsyet e mësipërme kërkojmë miratimin e transferimin dhe transportin e nxënësve nga shkolla e bashkuar “Sotir Çapo”, Zharrëz në shkollën “Koli Dima”, Frashër dhe anasjelltas.

Miratimin e fondit të sipërpërmendur me vlerë prej 1,123,200 (një milion e njëqind e njëzetë e tre mijë e dyqind) lekë për transportin të 108 (njëqind e tetë) nxënësve për 130 (njëqind e tridhjetë) ditë mësimore.

Miratimin e fillimit të procedurave për marrjen me qera të një objekti si dhe miratimin e fondit prej 320,000 (treqind e njëzetë mijë) lekë për mbulimin e qerasë

Bashkëlidhur relacionet përkatëse.

Eduart Faslliaj- më thoni rikonstruksioni i shkollës Sotir Çapo, kur është afat i kohor që përfundon se më thatë që ju po kërkon mbas një përllogaritje për një periudhë 130 ditore dmth ditë mësimore që do të thotë në kështu në muaj sa i bie? Na përkon me afatin kohor?

Mitjon Nikolla - Mbi 6 muaj 7,8 muaj

Eduart Faslliaj- Kur është afati fundit i përfundimit të rikonstruksionit të shkollës?

Mitjon Nikolla-kontrata siç e dimë nuk është nënshkruar akoma nënshkrimi kontrate nga shpalla e fituesit përfundimtar bëhet brenda 60 ditësh që do të thotë e kemi përllogaritur që muajnin tjetër e kemi kontratën të nënshkruar pas miratimit të lejes së ndërtimit dhe procedurave tjera që atëherë në total afati punimeve është 10 muaj për këtë arsye unë kam kërkuar të dijë pasi duhet të shikojmë ditën e saktë dhe të fillimit të ofrimit shërbimit dhe fundin pasi nuk duam që ngarkojmë kostot të tepërta

Eduart Faslliaj- Unë jam sqaruar në qoftë se ka dikush tjetër kisha një pyetje tjetër në vazhdimësi të kësaj është gjetur objekti për ciklin e ulët në Zharrëz dhe është lidh kontrata?

Kryetari Bashkisë - afati punimeve në mos gaboj duhet të jetë 12 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës por duke qenë se shkolla mbaron në qershor atëherë për muajin qershor korrik gusht nuk është nevojshme të lidhim kontratë që tani për pjesën e transportit edhe për pjesën objektit të marrë me qira, përse i përket pjesës së lidhjes së kontratës dhe gjetjen të objekti nuk gjendet objekti pasi ajo shpallet si thirrje dhe pastaj varet kush vjen dhe që ofron objektin që ka në zonë normalisht kjo është si procedurë domethënë atje janë disa objekte besoj se njëri nga ata në nëqoftëse jo jemi detyruar që të futemi përsëri në këshillë më për të miratuar transport për të bërë dhe pjesën tjetër të fëmijëve për të mundësuar transportin nga shkolla nga Zharrëza në një shkollë tjetër që mund të jetë shkolla Muhamet Shehu në qoftë se nuk do finalizohet marrja me qera e një ambjenti në njësinë administrative Zharrëz.

Eduart Faslliaj- kryetar përfitoj nga rasti edhe dy minuta pa bezdisur kolegët desha të risjellë në vëmendje blerjen e një mjeti me një kapacitet rreth 20 vendesh apo 25 që do t'na shërbente për shumë gjëra për sportin do të na shërbente për këtë rast do na shërbente për të disa lloj transportesh për linjën e lagjes Mustafa Matohiti që sot e kësaj dite nuk funksionon kështu që blerja e një mjeti po të bënim dhe një përllogaritje për afër Moza ndoshta të na ndihmonte tek pjesa financës do ishim shumë më të fituar nëse nuk kishim blerë një ose dy mjet sesa kishim shpërndarë kështu buxhet

gjithsesi unë jam pro këtij akti sepse do duhet ta miratojmë sepse ata fëmijët të asaj zone do duhet që të vazhdojnë procedurë po desha të sjellë në mendje dhe do doja opinionin tuaj kryetar çfarë keni planifikuar për këtë gjë?

Kryetar i Bashkisë- Përsa i përket marrjes së një mjëti tjetër furgon që i plotëson le të themi edhe kushtet e ekipit të Albpetrolit por përveç kësaj edhe për të punuar le të themi part time si zëvendësues për furgonin e linjës Patos lagjja Mustafa Matohiti në raste kur ai është i dëmtuar por kjo do një analizë pak më të thelluar dhe mund të futet në buxhetin e vitit të ardhshëm këtë vit ne nuk kemi mundësi për të bërë ndryshime të këtij karakteri për muajin tjetër pasi është afati fundit për regjistrat e prokurimit është data 15 tetor pas asaj date nuk mund të shtojmë dot regjistra të tjerë për prokurimet kështu që do ngeli për fillimin e vitit të ardhshëm që besoj se duke u konsultuar edhe me qytetarët vendosja në buxhetin e vitit 2026 për blerjen e mjetit tjetër furgon për lëvizjen e administratës apo edhe të ekipit të albpetrolit në rastin kanë ndeshjet jashtë qytetit por kjo ngelet për tu parë për buxhetin e 2026. Një mjet që duhet të jetë të paktën me 20 apo 22 vende në mos gabo.

Erald Çepele- unë mendoj që studimi që është bërë është i cinguar si nga ana 130 ditore që keni përcaktuar efektet financiare për transportin janë pak se në rastet se filloi qoftë dhe muajin tjetër i bie rreth 6 muaj i bie të paktën 180 ditë apo 7 muaj kurse pjesa tjetër e sigurimit të ambientit mendoj që një ambient të tillë nuk mund të gjeni dot në salla mund të jetë një banesë ose ndonjë lokal që mund të jetë aty afër gjë cila nuk ofron as në ndarjen me klasa dhe as tualetet që do të thotë në rast se do merret përsipër kjo nga bashkia duhet të sigurojë edhe ndarja me gips dhe sigurimi tualeteve që do të thotë kosto në nëqoftëse pagesa për qira është 320 mijë lekë të reja të sigurojë që kostoja e ndarjes së ambienteve me gips me dyer edhe me tualete do të jetë dyfish apo trefish më e lartë sesa kjo gjë e cila nuk është parashikuar dhe nuk e ke një ambient të tillë ta siguroj unë nuk e keni të tillë që të kesh të ndarë në klasa të sigurojë tre tualete kështu që nuk mund ta bëjë me 320 mijë lekë se 320 mijë lekë nuk bëjnë vetëm tualetet kështu që mendoj që do të jetë një zgjidhje tjetër kjo është e dështuar pa filluar për mua.

Kryetari i Bashkisë- përsa i përket pjesës së ditëve 130 ditë ato llogariten me ditë mësimore që janë pesë ditë në javë zakonisht 20 ditë në muajin që del edhe vlera transportit në rastin se ne nuk do gjejmë një objekt që të jetë i përshtatshëm për fëmijët atëherë do shkojmë prapë për të marrë një për të kaluar vlerë tjetër për pjesën transportit do bëhen të dyja bashkë ndërsa është diçka që edhe fëmijët në një farë mënyre prindërit në këtë rast duhet të jenë dhe ata dakord me gjithë pjesën që për pjesën e mësimin me turne nuk jam dakord, rasti më i mirë në rast se nuk do të finalizohet pjesa e marrjes së objektit me qera ngelet gjithmonë shkolla Muhamet Shehu kati i parë që aktualisht ka disa klasa bosh edhe plotësojnë numrin e fëmijëve që janë nga shkolla Sotir Çapo janë më shumë se pesë ,gjashtë klasë në mos gaboje.

Erald Çepele- Ne na duhet të ndërhyjmë prap për të rritur vlerën e transportit.

Kryetari i Bashkisë - kjo ngelet për tu vlerësuar, ne do shohim njëherë për ambient në qoftë se është mundur, nëse s'eshtë i mundur është një gjë që nuk zgjat si afat brenda le të themi datës 15 të tetor që ne mund të bëj ndryshime besoja e kapim si datë përsëri besojmë që të jetë një ambient i përshtatshëm që të plotësojë kriteret që janë të nevojshme

Armand Ahmetaj- Kemi ndonjë pyetje? Atëherë kalojmë në votim e pikës së njëmbëdhjetë Projekt-vendim "Për miratimin e transferimit të nxënësve të shkollës "Sotir Çapo" Zharrës".

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër ska, abstenim ska, miratohet me 16 vota pro.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Simona Hoxha
Lori Musaj
Rendola Shpete

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2744 / 2 Prot.

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dymbëdhjetë të rendit të ditës.

Për miratimin e raportit “Për një zëvendësim në VKB nr. 41 datë 27.07.2023 “Për rishqyrtimin, miratimin dhe përbërjen e kryesisë së komisioneve të përhershme i ndryshuar.

Artan Velçani – Kryetari i grupit të partisë Socialiste – kjo ka të bëj dhe me pikën 13 dhe nga diskutimi që bëri Eduarti më parë dhe vëmendjes që unë i kushtova unë mendoj që të dyja këto projektvendime ne mund ti kalojmë për mbledhjen e radhës pavarësisht se mund të mëkatojmë me ndonjë gjobë të vogël në raport me afatet unë nuk shikoj se mos zbatimi i afateve këtu do tna sjelli ndonjë pengesë

Armand Ahmetaj- 2 muaj e ka anëtari i komisionit, 3 muaj anëtari,

Artan Velçani – unë mendoj se këtu kemi të bëjmë me 2 vlerësime vlerësimin e dy raporteve e para punës njëhërë që vendimmarrja ka qenë e përbashkët në raport me anëtarin që kështu i takon opozitës si dhe e dyta është fakti që duhet të sigurohet përqindja e gjinisë në komisione po edhe për shkak të faktit që nga sa vura re unë që grupi i djathtë ka vetëm një gjinisë femërore në përbërjen e tyre e cila nuk është prezente dhe nuk do ishte hijshme që ne pa marrë dhe konsensusin e saj të vendosim kështu që unë mendoj që të dyja këto pika të shtyhen për mbledhjen e ardhshme.

Armand Ahmetaj- paraprakisht jemi rregull me procedurën kryetarët e grupeve politike për rastet në fjalë duhet të kishim paraqitur një shkresë dhe mos ta linin këtë problem të sqaronim në mbledhje pra rregullorja kërkon që mbledhet grupi politik dhe paraqet listën e vetë emërore të cilën e ka votuar brenda grupit politikë dhe kryetari e propozon mbledhjen si të mirëqen pra votohet në shumicë pra herën tjetër për mbledhjen tjetër meqenëse ti e bërë këtë propozim dhe unë do ta hedh në votë për shtyrje në mbledhjen e ardhshme, mirë është ti hedhim në votë të dyja pikat siç e do rregullorja një nga një

Kush është dakord me propozimin e Artan Velçanit për shtyrjen shqyrtimit të pikës 12 për mbledhjen e ardhshme?

Armand Ahmetaj –Kush është dakord

Kundër 1, abstenim ska, miratohet me 15 vota pro.

Rafeala Xeba- Është Abstenim dhe Eraldi

Kundër 1, abstenim 1, miratohet me 14 vota pro.

Erald Çepele - ligji thotë duhet sigurohet barazia gjinore nuk na thotë se nga kush radhë duhet të zgjidhet ne kemi gjithë drejtën si shumic mund të propozojmë nga gjinia femërore një anëtar nga grupi partisë socialiste kështu që unë propozoj Vjollca Kasaj dhe mund ta miratojmë që sot sa të gjejnë ata mirëkuptimin në muajt në vazhdim.

Armand Ahmetaj- Të lutem Erald ngrite një herë dorën që e shtytem tani propozon bie parimi i sistemi demokratik të lutem tani nëse ne do t'i marrim gjithë anëtarët hajd po I marrim edhe po nuk është kështu pra, tani unë nuk u kanë faj lexojeni rregulloren se aty e keni çu tu them unë Në qoftë se unë nuk kam një propozim për votim të anëtarit të komisionit nuk mund ta bëj derisa grupi politik thotë që ne do ta shtyjme dhe këshilltarët votojnë për ta shtytur unë cfarë do hedh në votim


Erald Çepele - në rast se në mbledhjen e ardhëve të ardhshme nuk do paraqitet prapë anëtarja e opozitës së një anëtare kanë dhe detyrimisht automatikisht ajo do të shkojë nuk do paraqitet ose nuk do pranojë atëhere në të shtyjme të shkelim ligjin

SEKRETARE
Refaela Xeba



Smerodol Hoxhaj
Lori Musaj
Bendito Shyate

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 2774/1 Prot.

Patos më 26.09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së trembëdhjetë të rendit të ditës.

Për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Patos në Këshillin e Qarkut Fier.

Armand Ahmetaj - E njehta pyetje vlen dhe për pikën e 13 për zëvendësimin e përfaqësuesit të Këshillit të Bashkisë Patos në Këshillin e Qarkut Fier
kush është dakord me propozimin e kryetarit të grupit të partisë socialiste z. Artan Velçani për shtyrjen e shqyrtimit të mbledhjen tjetër.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord
Kundër ska, abstenim 2, miratohet me 14 vota pro,

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerol Hoxhi
Lori Musaj
Rendola Shyda

KRYETAR
Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr 2772 Prot.

Patos më 26 .09.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 22.09.2025 ora 14:00 , në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërmbëdhjetë të rendit të ditës.

Informacion mbi raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e dytë.

Mimoza Shtëmbari- në zbatim të ligjit financiar dhe të kontrollit ligji 68 “Për Financat e Vetqeverisjet Vendore” bashkia harton raportet e monitorimi çdo 4-mujor dhe informon këshillin bashkiak për tregueset e realizimit dhe nivelin e këtyre treguesve bashkëlidhur këtij raporti janë objektivat e realizuara janë tabelat për realizimin e burimeve tabela e realizimit ku janë pasqyruar niveli realizimit të ardhurave vendore për 4-mujorin e dytë dhe progresivë, kemi pasqyrën e treguesve financiarë mbi realizimi sipas klasifikimit ekonomik gjithashtu raporti përmban realizimin sipas programeve dhe tabela nr. 5 përmban realizimin e investimeve dhe statusin e çdo investimi në stadin ku ndodhet për periudhën raportuese gjithashtu në material në këtë raport është pasqyruar dhe niveli i realizimit të transfertës së kushtëzuar nga pushteti qendror, objektet për të cilat ne administrojmë këto fonde dhe treguesit financiarë të cilët janë kryesorët dhe bashkëlidhen këtij raporti pjesë përbërse e tij dhe ky raport pasi kalon në këshill për informim i gjithë publikohet në faqen zyrtare të bashkisë për të cilën vijnë rekomandimet nga Ministria e Financave dhe bëhen pjesë e këtij raporti për 4 mujorin tjetër raportues.

Erald Çepele – shikoj një realizim rreth 35% të ardhurave për tetë mujorin ku më bie në sy që zë një vlerë goxha të konsiderueshme tarifa për pastrimin nga 42 milion e 231 mijë është realizuar në 48% 20 milione 453 mijë e 394 lekë gjithashtu edhe tarifa vendore për ndotje mjedisi 34.38% nga 44 milion 35 mijë 15 milion, çfarë kanë ndikuar në këto dy zero konkretisht në mos realizimin e të ardhurave

Kryetari i Bashkisë - pjesa e mosrealizimit të të ardhurave është arsye kryesore janë në dy subjekte, është Bankers dhe Albpetroli që ende nuk e kanë bërë pagesën vazhdojnë pagesën me këtë kështu që do reflektojë deri fundvitit do shikohet një përmirësim i ndjeshëm pasi ata zënë dhe peshën më madhe për pjesën e taksës në bashki, gjithashtu dhe renta minerare këtë vit flas në total renta minerare ka qenë më e ulët se viti i kaluar edhe vazhdon të jetë akoma më e ulët sepse varet sesa naftë nxjer këto janë arsyet kryesoret që zënë pjesë më të madhe në përqindje.

Armand Ahmetaj- Mbledhja deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE
Refaela Xeba

Smerda 162124
Cori Musaj
Rendito Shpate

KRYETAR
Armand Ahmetaj